


Nëse dikush që njihni ka përjetuar diskriminim të strehimit, kontaktoni **PSDU** tani. Kur ju kontaktoni **PSDU-në** ne do të:



- Dëgjojmë historinë tuaj dhe do të mbledhim informacion të rëndësishëm;
- Hetojmë imtësisht ankesën duke përdorur kontrollorët e të drejtave civile nëse është e nevojshme;
- Ofrojmë ndihmë ligjore që mund të përfshijë këshillimin tuaj, bisedimet me një qiradhënës, ose ngritjen e një padie në emrin tuaj.

Shërbimet e PSDU-së janë falas.

Strehimi i Drejtë është Ligj !
Gjithmonë raportoni çdo incident të diskriminimit.

Kontaktoni PSDU në

508-752-3718

1-800-649-3718

TTY: 508-755-3260

Puna që siguroi bazën për këtë publikim u mbështet nga financimi me një grant me Departamentin e Strehimit dhe Zhvillimit Urban të SHBA-së. Përmbajtja dhe gjetja e materialit janë të dedikuara për publikun. Autori dhe botuesi janë vetëm përgjegjës për saktësinë e deklaratave dhe interpretimeve të përmbytura në këtë publikim. Interpretime të tilla nuk

NDIHMA LIGJORE
NË KOMUNITET

Projekti i Strehimit të Drejtë i Uorchesterit
405 Main Street, 4th Floor
Worcester, MA 01608

Strehimi i Drejtë dhe Personat me Aftësi të Kufizuara



**Projekti i Strehimit të Drejtë
i Uorchesterit (PSDU)**

**Ndihma Ligjore në
Komunitet**

Ne mund t'ju ndihmojmë!

Ligji shtetëror dhe ai federal parashikojnë mbrojtje për individët me aftësi të kufizuara për të siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në strehim. Individët të cilët kanë një histori me aftësi të kufizuara ose që perceptohen si persona me aftësi të kufizuara, gjithashtu mbrohen.

Ligji shtetëror dhe federal **e ndalojnë diskriminimin e strehimit** që bazohet në aftësitë e kufizuara të qiramarrësit.

Llojet e diskriminimit

Ofruesit e banesave mund të shkelin ligjet e strehimit të drejtë nëse bëjnë gjërat në vijim për shkak të aftësisë së kufizuar të qiramarrësit:

- Refuzojnë të shesin apo të japin me qira një pronë
- Ngarkojnë tarifa apo depozita shtesë
- Kufizojnë përdorimin e pajisjeve që janë në dispozicion të qiramarrësve të tjerë (p.sh., një pishinë, palestër ose klub)
- Ju japin informacion të rremë në lidhje me disponueshmërinë e banesave
- Pyesin nëse qiramarrësi i mundshëm është në gjendje të jetojë i pavarur
- Refuzojnë të bëjnë modifikime ose përshtatje të arsyeshme

Përshtatjet/Modifikimet

Ligji shtetëror dhe federal parashikojnë gjithashtu që ofruesit e banesave duhet të bëjnë përshtatje të arsyeshme ose modifikime të arsyeshme.

Një **përshtatje e arsyeshme** është ndryshimi i një rregulli, politike apo praktike, i nevojshëm që një person me aftësi të kufizuara të përdorë e të gëzojë strehimin e tij apo të saj.

Një **modifikim i arsyeshëm** është një ndryshim fizik në një shtëpi apo banesë, i nevojshëm që një person me aftësi të kufizuara të përdorë plotësisht e të gëzojë strehimin e tij apo të saj.

Si për përshtatjet e arsyeshme, edhe për modifikimet e arsyeshme, kërkesa duhet të lidhet me aftësinë e kufizuar, të jetë e arsyeshme dhe të mos ngarkojë një barrë të panevojshme mbi pronarin. Në disa raste të modifikimeve të arsyeshme, qiramarrësi mund të jetë përgjegjës për koston e modifikimit.



Kërkimi për një përshtatje

Personi me aftësi të kufizuara (ose dikush në emër të tij) duhet të kërkojë ndryshimin në rregullore, politike apo praktike. Ofruesi i banesës përgjithësisht mund të kërkojë për provë të paaftësisë së personit (nëse nuk është e dukshme) dhe provë që kërkesa lidhet me aftësinë e kufizuar.

Kërkesa të zakonshme

- Parkim i rezervuar pranë njësisë
- Lejimi i qiramarrësit që të mbajë ndihmës që jeton me të
- Lejimi i një kafshe ndihmëse, pavarësisht politikës “jo kafshë shtëpiake”
- Zgjerimi i dyerve ose instalimi i hekurave ndihmës



Cështje të veçanta me kafshët ndihmëse

Një kafshë ndihmëse nuk është kafshë shtëpiake. Ajo i ofron ndihmë personit me aftësi të kufizuara. Një kafshë ndihmëse **nuk ka** nevojë të ketë stërvitje të veçantë apo të jetë certifikuar si kafshë shërbimi.